

2. Qëllimet dhe ndërtimi i kësaj fletoreje

Të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhën e parë nuk janë aftësi të çfarëdoshme, të cilat mund të lihen anash në mërgim. Aftësimi i nxënësve/eve për të mbledhur dhe përpunuar informacione me shkrim në gjuhën e tyre të parë, është një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e tyre tërësor dygjuhësor-dyletrar. Për më tepër, zotërimi i sigurtë i gjuhës së parë e përkrah edhe mësimin e aftësive letrare në gjuhën shkollore të vendit pritës. Pra, kjo është, si një kompetencë shumë e lartë e ndikimit përzgjedhës, po edhe bazë për suksesin shkollor në mësimin e rregullt.

Kjo fletore do t'i përkrahë mësimdhënësit në detyrën e tyre të rëndësishme, që tek nxënësit/et e tyre të zhvillojnë dëshirën për të lexuarit në gjuhën e prejar-dhjes dhe ta përkrahin atë. Njëkohësisht kjo fletore do të tregojë rrugët, se si mësimdhënësit e MGJP mund t'i përkrahin nxënësit në mënyrë të qëllimshme në fushat e ndryshme të kompetencës në të lexuar, si për shembull tek të lexuarit e rrjedhshëm, kuptimi i tekstit ose kënaqësia për tekstet e krijuara.

Në pjesën hyrëse, fletorja paraqet një vështrim të shqetësimeve dhe përparësive të didaktikës aktuale të të lexuarit dhe trajton disa çështje specifike, të cilat janë me rëndësi për MGJP. Pjesa e dytë, praktike, përfshin 30 propozime konkrete për fushat, si p.sh. përkrahja e të lexuarit, ushtrimi në të lexuar dhe arsimimi letrar-kulturor. Këtu bëhet fjalë për nxitjet për mësimdhënësit. Ato mund të zhvillohen të shumtën e herës pa e ngarkuar shumë mësimin në aspektin kohor dhe në bazë të materialeve për lexim, të cilat edhe ashtu janë duke u trajtuar. Shumica e nxitjeve janë të përshtatshme – me përshtatjet specifike për moshën – për nxënësit/et e moshave të ndryshme. Kjo përputhet me rrethanat e MGJP, ku nxënësit/et e niveleve të ndryshme mësojnë bashkërisht.

3. Pikat kryesore të didaktikës aktuale të të lexuarit

Të lexuarit nuk mësohet nga sot e deri nesër. Rruga nga zbërthimi i shkronjave të veçanta e deri tek të lexuarit e rrjedhshëm të një libri të tërë është e gjatë. Bëhet fjalë për një proces tek i cili shumica e fëmijëve dhe e të rinjve duan të shoqërohen dhe të mbështeten vazhdimisht. Të rëndësishëm në këtë proces janë të rriturit – prindërit dhe mësimdhënësit – shtresa që merr pjesë në interesat e nxënësve/eve në të lexuar, shpesh krejt të ndryshme, e që janë të rëndësishme dhe me të cilët nxënësit/et mund të shkëmbejnë mendime mbi përmbajtjen e librave. Kjo mund dhe duhet të nisë para fillimit të shkollës: nëse prindërit tashmë me fëmijët e tyre krejt të vegjël shikojnë libra të ilu-

struar dhe i komentojnë, ose u lexojnë atyre tregime dhe diskutojnë për to, kjo paraqet një formë veçanërisht të frytshme të përkrahjes së hershme në të lexuar. Nëse u besojmë raporteve të përvojave të lexueseve dhe lexuesve, atëherë ekziston tek të rinjtë përkrahja efektive shkollore në të lexuar tek një mësimdhënës/e, që vetë njihet si lexues/e, që interesohet për parapëlqimet në të lexuar dhe të lexuarit tek nxënësit/et, që njej shumë libra të ndryshëm dhe të cilit i pëlqen që me nxënësit të inicojë dhe moderojë diskutimet stimuluuese mbi librat e lexuar.

Të lexosh me kënaqësi dhe të lexosh mirë - të dyja këto aspekte janë parakushte të rëndësishme për zhvillimin e suksesshëm të të lexuarit dhe gjithashtu janë të lidhura njëra me tjetrën: vetëm kush e ka gjetur kënaqësinë për tekstet dhe për atë çka tregohet në to, do të bëjë më tutje hapa të tjerë, të mundimshëm. Dhe e kundërta, nxënëset dhe nxënësit duhet të kenë disa aftësi në trajtimin e teksteve, ilustrimeve dhe përmbajtjeve, në mënyrë që të vazhdojnë me qejf dhe të jenë kureshtarë për lexime të tjera.

Mësimi në të lexuarit e përkrahur duhet t'i ketë parasysh pjesët e ndryshme të fushave të të lexuarit. Këtu lënë të dallohen tri fusha: përkrahja e të lexuarit, ushtrimi në të lexuar dhe arsimimi letrar-kulturor. Këto tri fusha plotësojnë njëra-tjetrën, por kompetencat e nevojshme për to shpesh nuk mund të ushtrohen njëkohësisht në të njëjtin tekst. Kjo vlen, natyrisht, edhe për mësimin dhe të lexuarit në gjuhën e prejar-dhjes. Por fushat individuale mund të ushtrohen dhe të përkrahin në mënyra të ndryshme, me tekste dhe detyra të ndryshme. Kjo ndikon pozitivisht për përvetësimin letrar në gjuhën e parë, si dhe në gjuhën e vendit pritës. Kjo fletore përmban një përmbledhje të ideve dhe të detyrave të gatshme për të tria fushat.

a) Përkrahja e të lexuarit

Qëllimi i përkrahjes së të lexuarit është që nxënëset dhe nxënësit t'i aftësojmë për të lexuarit. Ata duhet të jenë kureshtarë për tekstet dhe librat, duhet të kenë mundësinë të zgjedhin sipas shijes individuale, ata duhet të dinë se si librat dhe tekstet e tjera janë të shumëllojshme dhe sa emocionuese mund të jetë kur përmbajtjet shtjellohen përmes të lexuarit. Objektivi do të ishte që të lexuarit për nxënësit/et të bëhet një veprimtari e vetëkuptueshme dhe e përditshme – si në shkollë ashtu edhe në shtëpi, si në gjuhën e parë, ashtu edhe në gjuhën e shkollës.

Me rëndësi në lidhje me këtë qëllim është përzgjedhja e mirë dhe stimuluuese e teksteve, në mënyrë që mundësisht të gjithë nxënësit/et të gjejnë një lekturë, e cila u intereson dhe në të cilën dëshirojnë të thellohen. Në kuptim të një përzgjedhjeje të pasur përfshihen jo vetëm libra, por edhe revista, gazeta, comics, libra të ilustruar me fotografi dhe, natyrisht, një gamë e tërë tekstesh elektronike – nga faqet e internetit, me informacione për tema faktike e deri të chat forum dhe tek e-book-u.